



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 499/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2019, mori këtë

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa Anr.499/2019 e datës 20.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 fletëvotim në Vendvotimin 3032A/02R, të vlerësohet i pavlefshëm, dhe i njëjti të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar, i publikuar me datë 07.11.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 20.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.499/2019 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën pretendon se me datë 19.11.2019, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë rinumërimit të votave në kutin e vendvotimit 3032A/02R, është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013. Në kutinë 3032A/02R në të cilën gjendet fletëvotimi i kontestuar është shënuar shenja “TIK”, në katrorin e subjektit politik Nisma-Akr-Pd, mirëpo ngjitur me numrin 111 me të cilin numër ka garuar subjekti politik “Partia Liberale Egjiptiane” është shënuar me laps-kimik numri 2 i cili numër është rumbullakosur po ashtu me laps-kimik. Gjithashtu në këtë fletëvotim është shënuar në katrorin e numrit 119 një vijë e drejtë me të cilin votuesi shpreh qartë qëllimin e tij për të votuar edhe për subjektin politik AAK-PSD.

Prandaj sipas nenit 7 par.2, i Rregullës Zgjedhore 06/2013 të KQZ-së, përcakton qartë kriteret mbi të cilat një fletëvotim mund të shpallet i pavlefshëm. Fletëvotimi i gjetur dhe i numëruar në kutin 3032A/02R, kualifikohet brenda kornizave të nenit 7 par.2 pika a dhe b, të kësaj Rregulle Zgjedhore.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit 3032A/02R, nga ana e QNR-së, është shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim, në të cilin votuesi përveç se ka votuar për subjektin politik koalicioni NISMA-AKR-PD i njëjti në rubrikën-katrorin me numër 119 ka një vijë me laps-kimik, dhe megjithatë QNR-ja me rastin e numërimit e ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 4 lidhur me ndryshimin e nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm sepse bie në kundërshtim me Kodin e Etikës për Zgjedhje dhe mostrën 7 të Doracakut të KQZ-së.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se qëndron pretendimi i ankuesit se një fletëvotim i gjetur në kutinë e votimit 3032A/02R, pa të drejtë është shpallur i vlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk e përmbushë asnjërin kriter të vlefshmërisë, andaj i njëjti duhet të llogaritet si i pavlefshëm dhe duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar i publikuar më datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Fletëvotimi i shpallur i pa vlefshëm, të largohet nga rezultati i publikuar përfundimtar i datës: 07.11.2019.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 499/2019 më datë 21.11.2019

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Central Election Commission



ZI

499

3032A/02R

VENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2019
KËNDËSHËTARËT E PARTISË
KANDIDATËT E PARTISË
SHËNJINI MË SË SHUMTI PESË KANDIDAT
OZNAÇITE NAJVIŠË PET KANDIDATA

1

Shënjoni VETËM NJË subjekt politik
Oznaçite SAMO JEDAN politički subjekat

2 Shënjoni MË SË SHUMTI PESË kandidat
Oznaçite NAJVIŠË PET kandidata

- 111. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE
- 112. PDK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
- 113. PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI
- 114. STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE - SDA
- 115. PARTIJA KOSOVSKIH SRBA - PKS
- 116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK
- 117. POKRET ZA GORA - PG
- 118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS
- 119. AAK- PSD PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË
- 120. SLOBODA
- 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS
- 122. NISMA SOCIALDEMOKRATE ALEANCA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISË
- 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- 124. KOALICIJA VAKAT
- 125. FJALA
- 126. LËVIZJA VETËVENDOSJEI
- 127. KOSOVA DEMOKRATIK TËRK PARTISI - KDTP
- 128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
- 129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
- 130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP
- 131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
- 132. ESMIR KASI
- 133. GRADANSKA INICIJATIVA GORE - GIG
- 134. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
- 135. SRPSKA LISTA

1	2	3	4 ✓
5	6	7	8
9	10 ✓	11	12
13	14	15	16
17	18 ✓	19	20
21 ✓	22	23	24
25	26	27	28
29	30	31	32
33	34	35	36
37	38	39	40
41	42	43	44
45	46	47	48
49	50	51	52
53	54	55	56
57	58	59	60
61	62	63	64
65	66	67	68
69	70	71	72
73	74	75	76
77	78	79	80
81	82	83	84
85	86	87	88
89	90	91	92
93	94	95	96
97	98	99	100
101	102	103	104
105	106	107	108
109	110		